

Çfarë duhet të
dini pas vaksinimit
kundër COVID-19
me vaksinën
Johnson &
Johnson/Janssen



NYC VACCINE FOR ALL:
SAFE, FREE, EASY

nyc.gov/covidvaccine

Albanian

Përpara se të largoheni nga ambienti i vaksinimit:

Sigurohuni që të merrni një dokument vaksinimi. Ai do të tregojë se cilën vaksinë keni bërë dhe datën në të cilën e keni bërë.

A duhet të kthehem për një dozë të dytë të vaksinës?

Jo. Vaksina e Johnson & Johnson është vetëm me një dozë.

Cilat janë efektet anësore të vaksinës?

Efektet anësore të zakonshme janë dhimbja ose ënjtja e krahut në vendin e vaksinës, dhimbje koke, dhimbje trupi, lodhje dhe temperaturë. Efektet anësore janë më pak të zakonshme te personat e moshuar dhe janë zakonisht:

- Të lehta deri në mesatare
- Fillojnë brenda tre ditëve të para pas vaksinimit (ditën pas vaksinimit është më e zakonshme)
- Pasi fillojnë, ato zgjasin një ose dy ditë

Çfarë të bëj nëse kam efekte anësore?

Telefonojini ofruesit të kujdesit shëndetësor nëse keni efekte anësore që ju shqetësojnë ose që nuk largohen pas disa ditësh, ose nëse pas 24 orësh vendi i vaksinës skuqet ose dhemb. Bisedoni me ofruesin e kujdesit shëndetësor për të marrë ilaçe pa recetë, si p.sh. acetaminofen (Tylenol) ose ibuprofen (Advil).

Raportoju efektet anësore në aplikacionin për celular V-safe të Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (Centers for Disease Control and Prevention, CDC). Për të mësuar më shumë dhe për të shkarkuar aplikacionin, vizitoni **[vsafe.cdc.gov](https://www.vsafe.cdc.gov)**. Efektet anësore mund t'i raportoni gjithashtu në sistemin e raportimeve të rasteve të efekteve negative (Vaccine Adverse Event Reporting System, VAERS), i cili menaxhohet nga CDC dhe Administrata për

Ushqimet dhe Barnat. Raportimet mund të bëhen në vaers.hhs.gov/reportevent.html ose nëpërmjet telefonit në numrin 800-822-7967. Informacioni që raportoni do të jetë konfidencial.

A mund të pësoj reaksion alergjik nga vaksina?

Reaksionet alergjike janë të pazakonta dhe fillojnë kryesisht brenda pak minutash deri në një orë pas marrjes së dozës. Shenjat e një reaksioni alergjik të rëndë përfshijnë vështirësi në frymëmarrje, ënjtje të fytyrës dhe fytit, rrahje zemre të shpeshta, skuqje në të gjithë trupin, marrje mendsh dhe plogështi. Nëse mendoni se po pësoni reaksion alergjik të rëndë, telefononi numrin **911** ose shkoni në spitalin më të afërt.

Kur fillon të funksionojë vaksina?

Nuk do të keni mbrojtje të plotë nga vaksina deri në dy javë pas vaksinës.

A mund t'i ndaloj masat e tjera kundër COVID-19 pasi të vaksinohem?

Jo. Masat parandaluese duhet t'i vijoni ende edhe pas vaksinimit:

- Qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë.
- Qëndroni të paktën 6 këmbë larg personave të tjerë.
- Mbani mbulesë për fytyrën.
- Lani duart dhe përdorni shpesh dezinfektues duarsh.

Ndërkohë që vaksina Johnson & Johnson ka treguar që i mbron njerëzit nga COVID-19, ne na duhet të mësojmë më shumë për kohëzgjatjen e mbrojtjes dhe nëse vaksina parandalon transmetimin.

A do të faturohem për vaksinën apo për vizitën shëndetësore?

Jo. Kompania e sigurimit mund të faturohet, por ju nuk do të faturoheni për tarifën e përbashkët ose ndonjë tarifë tjetër për vaksinën.

A mbrohet informacioni im personal?

Informacioni juaj personal është konfidencial dhe i mbrojtur. Informacioni juaj bazë (si emri, adresa, numri i telefonit, data e lindjes, raca dhe etnia, data e vaksinimit dhe lloji i vaksinës së marrë) do t'i jepen Departamentit të Shëndetit dhe Higjienës Mendore të qytetit të Nju Jorkut (Departamenti i Shëndetit i NYC), siç kërkohet nga ligji.

Çfarë të bëj nëse kam pyetje të tjera?

Mund t'i telefononi ofruesit të kujdesit shëndetësor ose numrit **311**.





E SIGURT

FALAS

E THJESHTË

**Ku mund të marr më
shumë informacion?**



Departamenti i Shëndetit i NYC:
nyc.gov/covidvaccine

**Departamenti i Shëndetit i shtetit
të Nju Jorkut:**
covid19vaccine.health.ny.gov

CDC:
cdc.gov/covidvaccine



Departamenti i Shëndetit i NYC mund t'i ndryshojë
rekomandimet sipas zhvillimit të situatës. **3.8.21**